

Prill 2025

Nr (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
22	03.04.2025	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: Cilat janë politikat dhe strategjitë kryesore që po zbaton Ministria për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri? Çfarë masash po ndërmerren për mbrojtjen dhe rehabilitimin e zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare? Si po menaxhohet ndikimi i industrisë së ndërtimit dhe turizmit në ekosistemet bregdetare dhe malore?</p>	15.04.2025	<p>Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024-2030 mbështetet në gjashtë shtylla kryesore: Investimet, Politika fiskale dhe rregullatore në turizëm, Menaxhimi i destinacioneve, Zhvillimi i produktit turistik, Marketingu i destinacioneve dhe Ngritja e kapaciteteve mbështetur në tre parimet bazë që janë aspekti social, mjedisor dhe ekonomik”.</p> <p>Gjithashtu kjo Strategji projektton krijimin, përmirësimin dhe konsolidimin e produkteve turistike duke e ndarë vendin në 6 rajone turistike: Rajoni turistik i bregdetit të Adriatikut, rajoni turistik verior i brendshëm, rajoni turistik i Tiranës, rajoni turistik i bregdetit të Jonit si dhe rajoni turistik jugor i brendshëm.</p> <p>Për mbrojtjen dhe rehabilitimin e zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare në Shqipëri, janë ndërmarrë një sërë masash gjithëpërfshirëse, të cilat synojnë ruajtjen e biodiversitetit, përmirësimin e gjendjes ekologjike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre territoreve me vlera të veçanta natyrore. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni përgjegjës që udhëheq këtë proces, përmes një strukture të organizuar dhe një qasjeje strategjike që përfshin</p>	Përfunduar	0

			<p>aspekte të ruajtjes, menaxhimit, monitorimit dhe ndërgjegjësimit.</p> <p>Një nga shtyllat kryesore të punës së AKZM, bazuar në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, është mbrojtja dhe ruajtja e natyrës, duke siguruar që zonat e mbrojtura të jenë të mbrojtura nga aktivitetet e paligjshme si prerjet e pyjeve, gjuetia pa leje dhe ndërtime të paautorizuara. Në të njëjtën kohë, një prioritet tjetër është menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i këtyre zonave, përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit që përfshijnë promovimin e ekoturizmit, edukimin mjedisor dhe përfshirjen e komuniteteve lokale në ruajtjen e natyrës dhe përfitimet që rrjedhin prej saj.</p> <p>AKZM realizon një monitorim të rregullt të gjendjes ekologjike të zonave të mbrojtura përmes rrjetit të administratave rajonale. Specialistët ndjekin nga afër florën, faunën dhe gjendjen e mjedisit për të identifikuar ndryshime apo probleme si dëmtimet nga aktivitetet njerëzore, ndotja ose zhvillimet që mund të ndikojnë negativisht në ekosistem. Monitorimi shoqërohet me kontrole të vazhdueshme në terren, në bashkëpunim me institucione të tjera, me qëllim mbikëqyrjen efektive të ligjshmërisë dhe garantimin e zbatimit të rregullave brenda zonave të mbrojtura.</p> <p>Një tjetër aspekt i rëndësishëm i punës së AKZM është parandalimi i zjarreve, të cilat përbëjnë një kërcënim serioz gjatë muajve të verës. Në këtë drejtim, janë hartuar dhe zbatuar plane specifike për menaxhimin e rrezikut nga zjarret, janë krijuar pika vrojtimi dhe janë intensifikuar patrullimet nga stafet lokale. Bashkëpunimi me strukturat e Emergjencave Civile, zjarfikëset dhe Forcat e Armatosura është thelbësor në</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>ndërhyrjet në raste zjarresh të mëdha. Gjithashtu, janë ndërmarrë fushata sensibilizuese dhe trajnime për komunitetet lokale për rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e kapaciteteve në parandalimin e zjarreve.</p> <p>Bashkëpunimi ndërinstytucional është një tjetër element kyç në ruajtjen e integritetit të zonave të mbrojtura. AKZM bashkëpunon ngushtë me Policinë e Shtetit, IKMT dhe prokuroritë për ndjekjen penale të veprimtarive të paligjshme që dëmtojnë natyrën. Njëkohësisht, partneritetet me organizata ndërkombëtare dhe agjenci donatore kanë ndihmuar në rritjen e kapaciteteve institucionale, në dixhitalizimin e proceseve të monitorimit, si dhe në financimin e projekteve të rehabilitimit ekologjik.</p> <p>Në kuadër të përpjekjeve për rehabilitimin e ekosistemeve, viti 2024 është shpallur zyrtarisht si “Viti i Pyjeve”, një nismë kombëtare që synon rikthimin e sipërfaqeve të degraduara pyjore dhe përmirësimin e kapacitetit të vendit për përbalimin e ndryshimeve klimatike. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024 janë mbjellë mbi 25.500 fidanë në të gjithë territorin e zonave të mbrojtura dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 janë mbjellë mbi 7.700 fidanë, përfshirë zona të prekura nga zjarret apo degradimi natyror. Rehabilitimi i këtyre sipërfaqeve është shoqëruar me masa për mbrojtjen e pyjeve të reja, promovimin e silvikulturës së qëndrueshme dhe përfshirjen e komuniteteve në mirëmbajtjen afatgjatë të tyre.</p> <p>Industria e ndërtimit dhe turizmit ka ndikuar në mënyra të ndryshme në ekosistemet bregdetare dhe malore, veçanërisht në zonat që gëzojnë statusin e mbrojtjes për shkak të vlerave të tyre natyrore dhe biodiversitetit. Ekosistemet bregdetare, që</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>përfshijnë laguna, plazhe, pyje dhe zona shkëmbore, janë të ndjeshme ndaj zhvillimeve ndërtimore, veçanërisht kur këto kryhen pa një plan të qartë mjedisor. Në raste të caktuara, ndërhyrjet për qëllime turistike mund të sjellin ndryshime në strukturën e habitatit ose në cilësinë e ujërave, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë te flora dhe fauna vendase. Po ashtu, edhe në ekosistemet malore si ato të Alpeve Shqiptare, Tomorrit apo Korabit, rritja e infrastrukturës turistike apo ndërtimi i rrugëve kërkon kujdes të veçantë për të mos cenuar ekuilibrin natyror, peizazhin apo speciet e mbrojtura që strehohen në këto zona.</p> <p>Për të përballuar këto sfida, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) ka një vendimtar në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre ekosistemeve. Një nga masat kryesore të ndërmarra nga AKZM është monitorimi dhe kontrolli i çdo aktiviteti ndërtimor brenda kufijve të zonave të mbrojtura. Çdo projekt që synon zhvillim brenda këtyre zonave duhet të kalojë nëpër një proces të detyrueshëm të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM) dhe të marrë miratimin e strukturave përkatëse të AKZM-së, duke u bazuar në planet e menaxhimit të miratuara për secilën zonë. Këto plane përcaktojnë qartë se cilat aktivitete janë të lejuara, cilat janë të kufizuara dhe cilat janë rreptësisht të ndaluara, në varësi të ndjeshmërisë ekologjike të zonës.</p> <p>Gjithashtu, AKZM angazhohet në terren përmes rrjetit të rojeve mjedisore dhe specialistëve të zonave të mbrojtura, të cilët patrollojnë, evidentojnë shkeljet dhe bashkëpunojnë me organet ligjzbatuese për të ndaluar ndërtimet e paligjshme dhe dëmet në natyrë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i punës së AKZM është nxitja e formave të qëndrueshme të turizmit,</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>përmes promovimit të ekoturizmit dhe aktiviteteve që nuk dëmtojnë mjedisin, siç janë shëtitjet në natyrë, vrojtimi i faunës, apo vizitat kulturore në harmoni me ambientin natyror. AKZM bashkëpunon gjithashtu me komunitetet lokale për të rritur ndërgjegjësimin mbi vlerat natyrore dhe për t'i përfshirë ata si partnerë në ruajtjen e natyrës, duke ofruar edhe mundësi të reja ekonomike përmes turizmit të qëndrueshëm.</p> <p>Për më tepër, agjencia organizon fushata informuese dhe edukative për publikun dhe turistët, si dhe vendos infrastrukturë të lehtë për orientimin e vizitorëve – tabela informuese, shtigje të shënuara, zona ndalese – që ndihmojnë në minimizimin e ndikimit të tyre në habitatet natyrore. Në këtë mënyrë, AKZM përpiqet të krijojë një balancë midis zhvillimit dhe ruajtjes së natyrës, duke siguruar që ndërtimi dhe turizmi të mos dëmtojnë ekosistemet e ndjeshme që janë thelbësore për qëndrueshmërinë mjedisore, ekonomike dhe kulturore të vendit.</p>		
23.	16.04.2025	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtare	22.04.2025	Kthyer përgjigje me shkresë	Përfunduar	0
24.	16.04.2025	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtare	22.04.2025	Kthyer përgjigje me shkresë	Përfunduar	0
25	18.04.2025	Kërkese për informacione në lidhje me: Në lidhje me specialistin në shërbimin civil, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ****	05.05.2025	<p>Në përgjigje të e-mail-it tuaj, përmes të cilit kërkoni informacion në lidhje me punonjësen e shërbimit civil në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit *****, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:</p> <p>***** është aktualisht punonjëse pranë MTM-së, në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Edukimit Mjedisor, në</p>	Përfunduar	0

		<p>-A është në shkelje pjesëmarrja e **** në manifestimet publike të Partisë Socialiste?</p> <p>-A është në shkelje të ligjit fakti se *** është anëtare e Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe kryetare e Njesisë Administrative Ndroq, Bashkia Tiranë? Kjo në bazë të listave të publikuara nga vetë kjo forcë politike.</p> <p>-Nëse ka dhënë dorëheqjen, ju lutem na e vendosni në dispozicion vendimin dhe miratimin e dorëheqjes së ****si anëtare e Asamblesë Kombëtare të PS, por edhe si kryetare e PS në Njësine Administrative Ndroq, Bashkia Tiranë.</p>		<p>Drejtorinë e Ekonomisë qarkulluese, në Drejtorinë e Përgjithshme për Zhvillimin e Turizmit, rekrutuar në këtë pozicion pune, përmes procesit të konkurrimit për procedurën “ngritje në detyrë”.</p> <p>Për rastin *****, institucioni ka kryer disa javë më parë një hetim administrativ, bazuar në një ankesë të mëparshme, të ngjashme me tuajën, lidhur me pretendime për pjesëmarrje të saj në organe drejtuese të Partisë Socialiste të Shqipërisë apo pjesëmarrje në manifestime publike të PS-së.</p> <p>Gjatë këtij hetimi, MTM kërkoi informacion zyrtar nga subjekti politik të cilit i atribuohet ankuesi, lidhur me vërtetësinë e informacionit të referuar prej tij, në raport me detyrimet dhe të drejtat e nëpunësit civil për ushtrimin e të drejtës së tij të bindjeve politike, mbështetur në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të tjera ligjore në këtë fushë. Referuar përgjigjes zyrtare të PS-së, ***** <i>nuk rezulton anëtare e asnjë organi drejtues të Partisë Socialiste. Gjithashtu, referuar analizave të fakteve, informacioneve të mbledhura, dokumenteve zyrtare dhe interpretimeve ligjore të bëra në to, rezulton se *****</i>, nëse është pjesëmarrëse në veprimtari politike, kjo veprimtari mund të jetë kryer jashtë orarit zyrtar të punës, në respektim të të drejtës politike të nëpunësit civil.</p>		
26	24.04.2025	Kërkese për informacion ne lidhje me: procedurën qe duhet te ndjek për t’u pajisur me certifikimin e nevojshëm si ekspert për leëshimin e VNM.	28.04.2028	<p>Aktualisht, kuadri ligjor, i cili rregullon këtë procedurë është në përpunim.</p> <p>Njoftimi për fillimin dhe vijimësinë e procedurës për certifikimin e ekspertit mjedisor, si dhe kriteret e dokumentacioni që do të kërkohen për të interesuarit, do të</p>	Përfunduar	0

				publikohen në vijim në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit(MTM), menjëherë pasi te jete miratuar Vendimi përkatës i Këshillit te Ministrave, lutem konsultimin e faqes zyrtare të MTM, për t’u informuar mbi fillimin e procedurave për marrjen e certifikatës së ekspertit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.		
--	--	--	--	---	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

- (5) Ndiemon kërkesin për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.